



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2392/6 Prot

Tiranë, më 14/08/2021

Lënda: Njoftim

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE VLORË

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar me Urdhërin nr. 107, datë 13.08.2020 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 14.09.2020 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” i ndryshuar me Udhëzimin nr.47, datë 31.12.2020, shkresës nr.717 prot, datë 21.07.2021 “Shpallje e vendit të lirë të punës në pozicionin Specialist në Zyrën Vendore Sarandë”, protokolluar në AKPA me nr.2392 prot, datë 26.07.2021, shkresës nr.2392/1 prot, datë 28.07.2021 “Njoftim për vend të lirë pune” të AKPA-s dhe procesverbalit të Njesisë së Burimeve Njerëzore nr.2392/4 prot, datë 17.08.2021, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit në faqen zyrtare të AKPA-së si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Vlorë, brenda datës 17.08.2021, si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton listën paraprake të kandidatëve të kualifikuar, sipas rendit alfabetik për pozicionin e punës: 1 Specialist në Sektorin e Zyrës Vendore Sarandë, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Vlorë, si më poshtë:

- Znj.Pranvera Selmani

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Elira DEMIRAJ